



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E AVOKATËVE
STUDIO LIGJORE "BEQIRI"
LICENCA NR.635, NIPT K61401025U

ADRESA: Kutia Postare 8288, Tirane
 Tel. 068 20 02 951 & 069 27 50 898
 E-mail. idajetbeqiri@hotmail.com

Nr.18/03 Akti

Tirane, me 04.04.2023

KALLËZIM PENAL

KALLËZUES: **IDAJET BEQIRI** i biri i Manes dhe Fazes, lindur ne Kute, Mallakaster dhe banues në Tiranë, Rr. Muhamed Gjolesha, i martuar, me 3 fëmijë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me gjëndje gjyqësore i pa dënuar, me nr. kontakti 068 20 02 951.

KUNDËR: **ZOTIT SALI BERISHA**, ish Kryeminister i Republikës së Shqipërisë.
ZOTIT ILIR META- ish Ministër i Ekonomisë.
ZOTIT EDMOND HAXHINASTO- ish Ministër i Energjitikës.
ZOTIT RIDVAN BODE-ish Ministër i Financave.
ZOTIT SOKOL DERVISHAJ- Ish Zëvendës ministër i Energjitikës.
ZOTIT ENGJËLL ZEQQO-ish Drejtor i Përgjithshëm i KESH.

OBJEKTI I KALLËZIMIT: Kërkohet fillimi i procedimit penal dhe kryerja e hetimeve, për kryerjen e veprave penale të : "Krijimi i bandës së armatosur dhe Organizatës kriminale", parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal; "Kryerja e krimeve nga banda e armatosur dhe organizata kriminale", parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal; "Fshehja e të ardhurave" parashikuar nga neni 180 i K.Penal; "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 245 i K.Penal; "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarim, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", parashikuar nga neni 257/a i K.Penal; "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i K.Penal; "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", në

bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, **Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, parashikuar nga neni 258 I Kodit Penal.**

BAZA LIGJORE: Nenet 25, 75/a, 149, 150, 151, 152, 153 - 165, 228, 229, 244, 277, 279/a, 280, 281, 283, 287, 304, 331, 390 të Kodit të Procedurës Penale të RSH; Nenet 180, 245, 257/a, 259, 287 të Kodit Penal të RSH.

PËR P A R A
STRUKTURËS SË POSAÇME TË KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
(SPAK)

T I R A N Ë

I nderuar Zoti Drejtues i SPAK,

Unë, kallëzuesi Idajet Beqiri, bazuar në nenin 283 të Kodit Procedures Penale, depozitoj këtë kallëzim penal ndaj shtetasve të sipërpërmendur për kryerjen e veprave penale respektive, pasi jam vënë në dijeni si qytetar dhe si avokat, si dhe pasi më janë afruar të dhëna të cilat ngrenë ***dyshime të arsyeshme se nga ana e Sali Berishës, Edmond Haxhinastos, Sokol Dervishaj dhe personave të tjerë në rolin e ndihmësit dhe të përfituesit janë konsumuar veprat penale të rënda të cituara në objektin e kallëzimit.***

Në bazë të fakteve të konstatuara, dokumente, akte të cilat do t'i përmend në vijim, ju paraqes këtë kallëzim penal, duke ju bërë prezent të gjitha shkeljet me natyrë penale, të cilat pretendoj se duhet të hetohen në mënyrë të thellë e të gjithanshme, pasi ngarkojnë me përgjegjësi të rëndë ligjore të natyrës penale personat që i kanë kryer dhe që unë i kallëzoj, të përfshirë në veprime të rënda të paligjshme, dhe që kanë sjellë pasoja shumë të rënda për ekonominë e Shqipërisë, për buxhetin e shtetit, për financat e shtetasve shqiptarëve, duke i pakësuar ndjeshëm ato.

Bazuar në faktin se personat që kallëzoj kanë patur funksionet më të larta në shtetin shqiptar dhe pranë tyre dhe në shërbim të tyre, qoftë nga pikpamja e ushtrimit të detyrave shtetërore, ose e të qënurit të tyre pjesë e organizatës kriminale, çka do të hetohen nga organi juaj, si dhe për shkak se në organizatën kriminale, ka dyshime të arsyeshme se si ndihmës të tyre janë të përfshirë edhe ish këshilltarë dhe punonjës të tjerë të tyre, por edhe gazetarë, analistë etj, për të mos prishur provat, për të mos i fshehur dhe asgjësuar ato, për të mos ndikuar te dëshmitarët okularë, të aplikohen ndaj të kallëzuarëve masa sigurimi personal sipas parashikimeve të neneve 228, 237 dhe 238 të Kodit Penal.

Për të njëjtat arsye që theksojmë sa sipër ndaj personave të kallëzuar të aplikohet sa më parë sa parashikohet në Seksionin IV, nenet 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Për disa dëshmitarë dhe ekspertë që japin të dhëna, prova dhe fakte për të kallëzuarit, si të dyshuar për kryerje të krimeve të rënda të kërkohet zbatimi i programit të mbrojtjes së tyre ose sa parashikohet në nenin 165/a të Kodit të Procedurës Penale.

Dispozita të aplikueshme

Neni 333

Krijimi i bandës së armatosur dhe organizatës kriminale

Krijimi i bandës së armatosur apo organizatës kriminale ose pjesmarrja në to, me qëllim për kryerjen e krimeve, dënohen nga pesë gjer në pesëmbëdhjet vjet.

Neni 334

Kryerja e krimeve nga banda e armatosur dhe organizata kriminale

I. Kryerja e krimeve nga banda e armatosur dhe organizata kriminale do të dënohet sipas dispozitave penale përkatëse duke shtuar dënimin për krimin e kryer edhe me pesë vjet burgim të tjera, kur dispozita referuese përmban dënim me burgim dhe një lloj dënimi më i lehtë, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim. Veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimin për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjobën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim.

II. Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm, dënohet me njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

III. Kur dispozita përkatëse referuese përmban vetëm dënim me burgim të përjetshëm, dënohet me burgim të përjetshëm.

Neni 180

Fshehja e të ardhurave

) ~~K KND/DSR/ KPD ID/ DSD LP L~~ detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përlogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo veprë kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se tetë milionë lekë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet □

Neni 245

Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë

3 P IP L S RSR IP L R G S ID G M S G MR s KR D L L o l D s GR S s IL IP L s SD
 funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në S s M

Neni 257/a

Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim.

“Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë, interesave privatë të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj. Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me E IP G L s M

Neni 259

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

. s NP Lose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimit të një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet. Po kjo veprë, kur përfitimi i parregullt ose premtimi i një përfitimi të tillë është mbi s s s s s s N s R s N L D F s s IP R G s s K D M G s R K s P s E IP s D s G L s s M

Neni 287

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale

3D IP L S R G N s S s S D R s IP D L s N IP L D s S s P M

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni,

L □ D □ KD □ IDN □ REMNL □

Neni 258

Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike

Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Mbi bazën e këtij kallzimi penal, duke i konsideruar pretendimet të drejta, si shqetësim dhe ndjeshmëri shumë të lartë të qytetarëve të vendit, të bazuara në ligj si dhe duke besuar në vlerësimin tuaj me seriozitetin e duhur, me profesionalizmin e lartë si dhe të pavarur, kërkoj:

- Rregjistrimin e procedimit penal në ushtrim të ndjekjes penale si dhe ngritjen e akuzave konkrete në përfundim të hetimeve.

- Procedimin e të kallëzuarve me masa sigurimi personal, në proporcion me shkeljet e kryera prej tyre dhe kërkimin për dërgimin në gjykim të çështjes penale.

Të kallëzuarit kryesorë, janë subjekte në kompetencë Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJ.K.K.O) pasi në bazë të nenit 135 pika 2 të Kushtetutës parashikohet: MND D

e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër **Presidentit të Republikës**, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, **deputetit**, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, **si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur** dhe nenit 75/a të K.Pr.Penale parashikohet: **Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:**

a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal;

...

c) **akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendës ministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;**

ç) **akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.**

SHKAQET E KALLËZIMIT

Referuar sa theksova më sipër, rezulton se:

RRETHANAT E FAKTIT

Ish ministri i Ekonomisë Ilir Meta është personi i parë i cili për arsye korruptive, kishte vendosur të nxjerrë në treg për shitje katër nga hidrocentralet e rëndësishme të vendit. Fjala është për shitjen e dy hidrocentraleve mbi lumin Mat, hidrocentralet e Ulzës dhe të Shkopetit, si dhe dy hidrocentralet e Bisticës në Jug të vendit. Më pas, Ish Kryeministri Sali Berisha, në rolin e drejtuesit të organizatës kriminale, ose të organizatorit në bashkëpunim, pasi ka korrupsionuar ish Ministrin e Energjitikës Edmond Haxhinasto dhe ish zëvendësministrin e energjitikës Sokol Dervishaj dhe punonjësit e tjerë të varësisë së tyre në Ministrinë përkatëse, pasi të gjitha sondazhet prestigjioze e nxirrnin humbës të zgjedhjeve të përgjithëshme parlamentare të 23 qershorit 2013, plotë 5 javë para këtyre zgjedhjeve, hartuan dhe miratuan 2 (dy) Vendime të Këshillit të Ministrave me anën e të cilave kryen veprat e rënda penale të korrupsionit përmes privatizimit të HEC-ve Ulzë, Shkopet, Bistrice 1 dhe Bistrice 2, përmes të cilave futën në xhepin e tyre një shumë të konsiderueshme të hollash, të cilat i morën si “shpërbllim” të kësaj afere korruptive nga përfituesit e këtyre privatizimeve që u bënë në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore dhe kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Nxjerrja në tender e katër hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit dhe dy HEC-eve të Bisticës përbën një rast të paprecedentë, kur Qeveria shet tek privatët vepra ekzistuese energjetike të ndërtuara gjatë kohës së regjimit komunist.

Të dhënat zyrtare të vetë Qeverisë që drejtonte ish Kryeministri Sali Berisha, ish Ministri i Ekonomisë Ilir Meta, ish ministri Edmond Haxhinasto, ish ministri Ridvan Bode, ish zëvendësministri Sokol Dervishaj, si dhe të dhënat zyrtare të KESH që drejtonte Engjëll Zeqo tregojnë se në total Ulza, Shkopeti dhe dy hidrocentralet e Bisticës kanë një fuqi të instaluar prej rreth 77 megavat, e barabartë kjo me 5.3 përqind të fuqisë totale të KESH-it.

Të katra këto hidrocentrale prodhonin 406 milionë kilovat orë energji në vit ose 5.5 përqind të të gjithë energjisë elektrike që prodhon Shqipëria. Nisur nga fakti se prodhimi i energjisë elektrike në vend përllogaritet që gjeneron mbi 200 milionë euro në vit, personat e kallëzuar penalisht Sali Berisha, Ilir Meta, Edmond Haxhinasto, Ridvan Bode, Sokol Dervishaj, Engjëll Zeqo etj, duke u dhënë privatëve në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës dhe ligjet përkatëse që rregullojnë këtë fushë të rëndësishme të ekonomisë së vendit, sikurse është energjitika, përmes shitjes së këtyre 4 hidrocentraleve, u pakësoi shqiptarëve dhe buxhetit të shtetit 10 milion dollarë të ardhura për çdo vit. Nga viti 2013 dhe deri më sot buxhetit të shtetit dhe taksapaguesëve shqiptarë u janë vjedhur 100 milion dollarë.

Të dhënat zyrtare tregojnë se katër hidrocentralet e shitura në mënyrë abuzive prej ish Kryeministri Sali Berisha, ish ministrit Ilir Meta, ish ministri Edmond Haxhinasto, ish ministri Ridvan Bode, ish zëvendësministri Sokol Dervishaj, si dhe ish Drejtorit të KESH Engjëll Zeqo, kanë normat më të larta të fitimit. Së bashku me HEC-in e Lanabregasit, që iu shit Drejtorisë së Ujësjellësit në vitin 2010, këto hidrocentrale dhanë rreth 6 përqind të të ardhurave totale të KESH, por ndërkohë për të njëtin vit zunë vetëm 2.9 përqind të shpenzimeve. Ky tregues dëshmon se normat e fitimit tek HEC-et që këta të kallëzuar shitën abuzivisht ishin të paktën dy herë më të larta nga mesatarja e KESH, duke konfirmuar kështu leverdishmërinë e tyre të lartë.

Hidrocentrali i Shkopetit dhe dy Hidrocentralet e Bisticës u shitën pikërisht në momentin që sapo kishin marrë investime të mëdha nga fondet e buxhetit të shtetit dhe nga ndihmat e mëdha të Qeverisë së RF të Gjermanisë, çka u dha mundësinë privatëve që i përvetësuan këto pasuri kombëtare të mos bëjnë asnjë investim, por të merrnin të pastër 10 milion dollarët për çdo vit.

Ish Kryeministri Sali Berisha, ish ministri Ilir Meta, ish ministri Edmond Haxhinasto, ish ministri Ridvan Bode, ish zëvendësministri Sokol Dervishaj, si dhe ish Drejtorit të KESH Engjëll Zeqo, në bashkëpunim me disa ekspertë të tyre, përgatitën aferën korruptive duke ndryshuar fillimisht vendimet e Këshillit të Ministrave, si dhe duke nëpërkëmbur dhe anashkaluar Ligjin nr. 8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë". Këta të kallëzuar i shitën katër HEC-et, me 132.2 milion euro më pak.

Provë e rëndësishme që vërteton aferën korruptive të të kallëzuarëve e kanë dhënë vet këta të kallëzuar, të cilët me vendimin Nr. 717, datë 20.10.2011 "Për transferimin e 100% të aksioneve të Shoqërisë HEC-i Lanabregas Sh.a, Tiranë, zotëruar nga METE, shitur Shoqërisë "Ujësjellës-kanalizime" Sh.a Tiranë", e shitën 15 milion euro. Ndërsa katër HEC-et "Bistrica 1", "Bistrica 2- sh.a", "Ulëz" e "Shkopet" u shitën me 1.6 milion euro më pak se vlera e HEC-it të "Lanabregas"!

Ish Kryeministri Sali Berisha dhe organizata kriminale ose bashkëpunëtorët e tij, për të përmbysur kriteret ligjore të sakta dhe në mbrojtje të interesave të shtetit dhe të qytetarëve, si dhe për t'i shitur të 4 HEC-et te i përzgjedhuri i tyre që bëri korrupsionin aktiv mbi t'a, ndryshoi dy VKM, atë me nr. 152 dhe 153, datë 29/02/2012, parashikonin krahas të tjerave që investitori strategjik të kishte eksperiencë në menaxhim HEC-eve, për shkak se ky investitor i përzgjedhur prej Sali Berishës nuk e plotësonte këtë kriter nga më të rëndësishmit, hartuan dy VKM të tjera nr. 676 dhe 677, datë 03.10.2012, dhe formuluan nenin 4.1, i cili përligjite aferën e rëndë korruptive, duke qënë këto dy VKM në kundërshtim të hapur me Ligjin nr. 8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", në një kohë që këto dy VKM duhet të delnin në bazë dhe për zbatimin e këtij Ligji.

Cilat janë shkeljet më të rënda ligjore që provojnë këtë korrupsion të rëndë dhe të dukshëm:

- I. U shmang zbatimi i Ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë". Neni 4 i ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 ka një paragraf ku shkruhet: "...Nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë ndërmarrjet, shoqëritë tregtare ose pjesë të tyre, të cilat kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike dhe kanë rezultat financiar me humbje për mbi 3 vjet rresht". Kjo pikë nuk lejonte shkeljen nga KESH për objektet rentabël siç ishin katër hidrocentralet dhe as privatizimin e tyre ndryshe.
- II. Për të realizuar qëllimin korruptiv, ish Kryeministri Sali Berisha, ish ministri Ilir Meta, ish ministri Edmond Haxhinasto, ish ministri Ridvan Bode, ish zëvendësministri Sokol Dervishaj, si dhe ish Drejtorit të KESH Engjëll Zeqo, ndryshe nga sa parashikohej në kuadrin ligjor, deformuan kriteret mbi cilësimin e investitorit strategjik. Fillimisht shpallen kriteret mbi cilësimin e investitorit strategjik (Neni 4.1), VKM nr. 152 dhe VKM 153 dt 29/02/2012. Mbase iu dështoi tenderi, bënë vendime qeverie (VKM nr. 676 dhe 677 dt 03/10/2012) për të ndryshuar kriteret mbi cilësimin e investitorit strategjik, duke shkelur haptazi ligjin 8306, datë 14.03.1998, edhe pse për ironi i referoheshin këtij ligji
- III. Mbase është shpallur fituesi, është bërë VKM dhe Urdhëri i Ministrisë së Financave për të lejuar zbritjen nga vlera e ofertës detyrimet që DPT i ka kompanisë fituese për TVSH e pa rimbursuar!. Kjo nuk ka qënë parashikuar në kushtet e Dokumentave Standarte të Tenderit (DST). Janë inkuadruar dy shkelje të rënda. Së pari, Neni 9 i Ligjit 8306 përcakton:

"Në çdo rast paketa që do të privatizohet me pjesëmarrjen e investitorit strategjik, do të paguhet me para."

Duke kompensuar përmes TVSH-së pa rimbursuar, është shkelur neni 9 i këtij ligji. Kuptohet, gjithçka e targetuar me qëllim favorizimi!

Së dyti, nëse përjashtimi nga Ligji 8306 parashikohej në DST, në garë mund të mermin pjese edhe kompani të tjera shqiptare...!

Qartazi është bërë favorizim dhe shkelje e barazisë në tendera për të dalë fitues Kompania "Kurum", e përzgjedhur prej Sali Berishës dhe Ilir Metës.

Sa më sipër, vlerësoj dhe ju kërkojmë të regjistrohet procedimi penal dhe të kryhen veprimet e domosdoshme hetimore ndaj të kallëzuarëve Sali Berisha, Ilir Meta, Edmond Haxhinasto, Ridvan Bode, Sokol Dervishaj, Engjëll Zeqo etj, për dyshimin e arsyeshëm se kanë bërë privatizimin e 4 HEC-eve Bistricë 1 e 2 dhe Ulëz e Shkopet përmes korrupsionit, në kuadrin e një organizate kriminale, kanë kryer veprat penale të : "Krijimi i bandës së armatosur dhe Organizatës kriminale", parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal; "Kryerja e krimeve nga banda e armatosur dhe organizata kriminale", parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal; "Fshehja e të ardhurave" parashikuar nga neni 180 i K.Penal; "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 245 i K.Penal; "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarim, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", parashikuar nga neni 257/a i K.Penal; "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i K.Penal; "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal.

Në ndihmë të provueshmërisë së akuzave, SPAK të thërres në cilësinë e dëshmitarëve okularë, që janë njëkohësisht ekspertë të nivelit të lartë, zotrinjtë Koço Broka, ish Kryetar i Komisionit të Konkurrencës si dhe Pajtim Bello, ish Zëvendësministër i Energjitikës.

**KALLËZUES
AV. IDAJET BEQIRI**